

5 mars

I LUMI GJON GAZULLI, MESHTAR E MARTIR

PËKUJTIM

Lindi në vitin 1893. Shërbimin famullitar e kreu në Dioqezën e Sapës, në Shqipëri. Mbarështimi i tij baritor u frymëzua nga Doktrina Shoqërore e Kishës. Kundërshtimi i tij ndaj planit shtetëror për t'i mbyllur shkollat katolike e bëri atë të papëlqyeshëm për regjimin. Me akuzën e rreme se kishte nxitur revoltën e Dukagjinit, në nëntor të vitit 1926, u arrestua dhe u dënua me vdekje. Ekzekutimi me varje u bë në Shkodër, më 5 mars 1927.

Nga Përbashkorja e një martiri apo nga Përbashkorja e barinjve: për një bari, me psalmet e ditës në psalter.

SHËRBESA E LEXIMEVE

LEXIMI I DYTË

Nga një «Relacion» që Imzot Lazër Mjeda, Arqipeshkëv i Shkodrës, ia dërgon Prefektit të Kongregatës së Shenjtë të Propaganda Fide-s.

(Kardinalit Guglielmo M. Van Rossum-it, 6 mars 1927; Romë, Arkivi Historik i Kongregatës për Ungjillëzimin e Popujve, Fondi - Seria e Re Shqipëria, vëll. 882).

Nën shembullin e Jezusit pranoi të vdiste pa faj dhe t'i falte të gjithë.

Natën e datës 4 të këtij muaji ka mbërritur papritur nga Tirana një oficer me urdhër për të ekzekutuar dënimin e Gazullit. U thirrën dy

franceskanët e caktuar për t'i ndihmuar të dënuarit dhe meshtari i gjorë u zgjua nga gjumi për t'u njoftuar për urdhrin e marrë.

Është e pabesueshme se me sa dinjitet dhe gjakftohtësi e priti lajmin, siç tregojnë priftërinjtë e lartpërmendur. Pa u mërziur ai kërkoi të rrëfehej dhe rrëfeu krejt jetën e tij, pastaj me shumë devocion mori kungimin e fundit. Më pas i kërkoi oficerit leje për të folur dhe ky ia dha. Tha se në atë moment solemn në të cilin do të dilte përpara Shëlbuesit për t'u gjykuar, e kishte për zemër të deklaronte se kurrë nuk kishte kryer ndonjë veprim në dëm të atdheut të tij, por se, si prift katolik, kishte punuar gjithmonë për të mirën e tij; se ishte i pafajshëm për akuzat e ngritura kundër tij; dhe se me gjithë këtë, duke ndjekur shembullin e Jezusit që vdiq i pafajshëm në kryq për shpëtimin e njerëzve, edhe ai pranonte të vdiste pa faj dhe se i falte të gjithë.

U nis për të shkuar te trekëmbëshi i shoqëruar nga dy priftërinjtë dhe nga ndoshta rreth njëqind ushtarë. Kur doli nga burgu kapiteni u urdhëroi ushtarëve që të paraqitnin forcën, madje edhe kur e shoqëronin të gjithë mbanin një qëndrim respektues. Meqenëse atë natë ishte e para e Ramazanit, agjërim për myslimanët, shumë prej tyre po silleshin nëpër qytet në atë kohë dhe, duke e vërejtur këtë fakt, u bashkuan me ushtarët për të shkuar te vendi i ekzekutimit.

Gjithë rrugën Gazulli e bëri me hap të vendosur, i përqendruar te Zoti dhe, me një zë të kuptueshëm, luste psalmin *Miserere* dhe Rruzaren e Shenjtë. Kur ishte te trekëmbëshi, u kthye nga turma dhe me zë të lartë e kumbues tha: «Rroftë Krishti Mbret; Rroftë Ati i Shenjtë; Rroftë Feja katolike; Rroftë Shqipëria me shqiptarë të vërtetë!». Pastaj hipi në stol, drejtoi trupin dhe tha: Jezus, Mari, Jozef, iu vu laku dhe vdiq duke puthur për herë të fundit Kryqin që prifti e mbajti pranë buzëve të tij.

Përshtypja e krijuar te njerëzit nga ky fakt mizor është shumë e madhe; vetë myslimanët e dënojnë një padrejtësi të tillë. Ashtu si të gjithë

e lavdërojnë dhe e admirojnë virtytin dhe guximin e të ndjerit dhe e numërojnë atë ndër të lumët e qiellit. Kështu përfundoi ky prift i ri dhe shumë i denjë, i vlerësuar dhe i dashur nga ata që e praktikonin fenë, i cili premtonte se do t'i bënte shërbime të shkëlqyera Kishës Katolike në Shqipëri.

PËRGJIGJJA

GJN 1,24-26

R. Ai që e do jetën e vet e humb atë dhe ai që e urren jetën e vet në këtë botë do ta ruajë atë për jetën e amshuar. Nëse dikush dëshiron të më ndjekë le të më ndjekë, * e ku jam unë, atje do të jetë edhe shërbëtori im.

V. Nëse dikush më shërben mua, Ati do ta nderojë.

R. e ku jam unë, atje do të jetë edhe shërbëtori im.

LUTJA

O Atë, që i ke mundësuar të Lumit Gjon [Gazulli], meshtar e martir, ta shpallë edhe nga trekëmbëshi fenë e tij në Krishtin Mbret dhe t'i falë përndjekësit e tij, nën shembullin dhe për ndërmjetësi të tij na bëj ndërtues të qytetërimit të dashurisë. Nëpër Zotin tonë.